



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAMI

**I INTEGRIMIT TË ÇËSHTJEVE QË LIDHEN ME FENË DHE BOTËKUPTIMEVE
FETARE DHE JO FETARE PËR BOTËN NË KURRIKULËN E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Tiranë, 2018



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

1 Tabela e përmbajtjes

1	Tabela e përmbajtjes	2
2	Qëllimi	3
3	Domosdoshmëria	3
4	Detyrimi në kuadrin e të drejtave të fëmijëve	4
5	Jo trajtim i njëanshëm.....	4
6	Pikënisje: kushtetuta dhe të drejtat e njeriut	5
7	Disa tipare të edukimit për çështje fetare	5
8	Parime themelore arsimore	7
9	Kompetencat themelore për nxënësit:	8
10	Metoda	9
11	Lëndë më vete/e integruar?	15
12	Pilotimi: synimet.....	15
13	Mësuesi	16

2 Qëllimi

Qëllimi i këtij programi është të fuqizojë fëmijët dhe të rinjtë me informacionet, njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për pranimin e arsyeshëm dhe respektimin diversitetit dhe të tjetrit, për zhvillimin e aftësive të vendimmarrjes mbi bazën e të qenit të mirinformuar, të trajtimit të çështjeve kundërshtuese dhe të zgjidhjes paqësore të konflikteve, të debatit të hapur etj.

3 Domosdoshmëria

Diversiteti kulturor dhe fetar janë të pranishëm në çdo vend. Asnjë shtet nuk është homogjen ng pikëpamja kulturore. Disa vende kanë pakica të konsoliduara etnike dhe fetare; shpesh me histori shumë të lashta, ndonjëherë që i paraprijnë formimit të shtetit. Shumë shtete kanë pakica të tilla si rezultat i migrimit nga vende të tjera të Evropës dhe më gjerë, kryesisht gjatë shekujve të 20-të dhe 21-të.

Diversiteti brenda shteteve është kompleks dhe lidhet me çështje globale, si dhe çështje rajonale, kombëtare dhe lokale.

Të gjithë këta faktorë lidhen me një pikëpamje të zgjeruar se **feja dhe besimi nuk janë çështje tërësisht private dhe duhet të jenë pjesë e diskutimit dhe dialogut brenda sferës publike.**

Bota e sotme është bota e informacionit të dendur dhe e teknologjisë së informacionit, e cila e përplas këtë informacion, të mbushur me pamje, mesazhe, ide, opinione, e shpesh herë, me mashtrime, propagandë, pasiguri, frikë, urrejtje, dhunë, ekstremizëm, me shpejtësi dhe intensitet të jashtëzakonshëm e kaotik tek fëmijët dhe të rinjtë.

Duke qenë pa njohuritë dhe aftësitë e duhura intelektuale, këta fëmijë dhe të rinj janë të pambrojtur, lehtësisht të cenueshëm e të përpunueshëm nga joshjet dhe rekrutimet e ofruara nga mjeshtrit e terrorizmit dhe organizatat e tyre.

Një edukim i gjerë në lidhje me fetë është i dëshirueshëm për të gjithë nxënësit e shkollave, pavarësisht nga përkatësia fetare ose jofetare, **për të luftuar paragjykimet ose intolerancën dhe për të nxitur mirëkuptimin reciprok dhe qytetarinë demokratike.**

Në kuadër të këtij programi, të kuptuarit e feve dhe të bindjeve jofetare shihen si një aspekt i rëndësishëm i mirëkuptimit ndërkulturor. Të kuptuarit e diversitetit kulturor shihet si një dimension i edukimit për qytetarinë demokratike dhe i edukimit për të drejtat e njeriut, të cilat janë të ndërlidhura ngushtë dhe reciprokisht mbështetëse.

4 Detyrimi në kuadrin e të drejtave të fëmijëve

Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të informohen për dukuritë dhe faktorët që ndikojnë në jetën e tyre, ndërsa shteti ka detyrimin ligjor t'ua bëjë të mundur këtë informacion përmes arsimit, në mënyrë cilësore, të strukturuar e në përputhje me parimet e demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës.

5 Jo trajtim i njëanshëm.

Trajtimi i faktit fetar dhe i këndvështrimeve fetare **nuk do të jetë qëllim në vetvete**, por do të zhvillohet **në kuadër dhe krahas trajtimit** edhe të faktorëve të tjerë dhe këndvështrimeve jofetare (sociologjike, filozofike, etike etj.)

Në këtë kuadër, **njohja e faktit fetar dhe e këndvështrimeve fetare të shikimit të botës do të plotësojnë tablonë e përgjithshme të dukurive shoqërore** dhe të këndvështrimeve të tjera që ekzistojnë për to, të cilët, krahas faktorëve të tjerë politikë, ekonomikë, kulturorë etj., luajnë rol në vendimet që individët marrin në jetë.

6 Pikënisje: kushtetuta dhe të drejtat e njeriut

Procesi i të mësuarit të faktit fetar dhe jo fetar, të këndvështrimeve fetare dhe jo fetare **do të ketë pikënisje kushtetutën e Shqipërisë, vlerat kushtetuese të qytetarisë, të drejtave të njeriut, barazinë, lirinë nga diskriminimi dhe lirinë e ndërgjegjes, e besimit fetar, e mendimit, e besimit dhe opinionit. Po kështu, ai do të respektojë laicitetin e arsimit, krahas parimeve të të drejtave të njeriut.**

Në këtë mënyrë, edukimi për fenë, në kuadrin e edukimit qytetar, e veçanërisht ndërkulturor, do t'i shërbejë krijimit të një individi të fuqizuar për vendimmarrje të arsyeshme dhe krijimit të një komuniteti të informuar dhe të integruar, që pohon unitetin në diversitet dhe di ta mbrojë atë në emër të bashkëjetesës paqësore.

7 Disa tipare të edukimit për çështje fetare

Së pari, Edukim për çështjet fetare është arsim. Njohuritë, të kuptuarit dhe vlerësimi i tërë diversitetit dhe literaturës fetare është pjesë e programeve mësimore të shkollës.

Zbatuesit e programit duhet të kenë parasysh:

Rreziqet/qëndrimet ekstreme

- *Feja në një sistem, arsimor rrezikon t'i shërbejë nxitjes së interesave të veçanta të fesë dhe të përkushtimit ndaj saj, duke u bazuar në bindjen ende të përgjithshme se problemet e shoqërisë sonë burojnë nga humbja e besimit fetar.*
- *Nga ana tjetër, rrezikohet përjashtimi i plotë i fesë në arsim, duke argumentuar që pranimi i ndërsjellë i humanizmit tonë të përbashkët është e vetmja zgjidhje për harmoninë shoqërore.*

Qëndrimi ynë:

Ne besojmë se do të bënim më shumë si vend nëse nxënësit tanë do të njiheshin me larminë e besimeve fetare dhe sekulariste, në mënyrë të mirinformuar, gjë që krijon terrenin për respekt të vërtetë edhe për ndjekësit e praktikave të ndryshme, pa ndikuar në zgjedhjet e parapëlqyera nga nxënësit.

Së dyti, Edukimi për fenë në arsim është **edukim për diversitetin për një shoqëri të larmishme**. Klasa gjithnjë e më shumë do të bëhet një hapësirë për larmi gjuhësore, kulturore dhe fetare. Shkolla duhet të krijojë mjedisin e përgjithshëm- një mjedis social, intelektual, emocional, qëndrimi e sjelljeje, organizativ dhe strukturor – **që zgjeron ndjenjën e pranimit**, të sigurisë dhe të respektojë për nxënësit me vlera e prejardhje kulturore e fetare të ndryshme dhe nga tjetër krijon barrierat e domosdoshme për ideologji, modele të menduarit e të sjellurit që minojnë harmoninë dhe bashkëjetesën në diversitet.

(E rëndësishme!!!) Të gjithë ne duhet të pranojmë faktin që vlerat nuk burojnë domosdoshmërisht nga feja dhe jo të gjitha vlerat fetare përputhen me kushtetutën.

Për këtë arsye, duke mësuar për vlerat fetare dhe shekullariste në një mjedis të hapur arsimor, shkolla duhet të sigurojë që **të gjithë nxënësit, pavarësisht nga raca, orientimi seksual, shkalla e aftësisë, gjuha, gjinia ose klasa të ndihen të mirëpritur, të sigurt nga ana emocionale dhe të vlerësuar.**

Së treti. Fetë janë të rëndësishme, megjithëse ato nuk janë burimi i vetëm i vlerave morale.

Feja mishëron vlera të drejtësisë dhe të mëshirës, të dashurisë edhe të kujdesit, të përkushtimit, të shqetësimit dhe bashkëpunimit. Ato paraqesin rrugë të ndryshme të të qenit njerëzor dhe të lidhjes me të tjerët dhe botën. **Vlerat morale nuk janë monopol i feve, aq më pak pronë ekskluzive e ndonjë feje të veçantë. !!!**

Ne besojmë se kur studimit të çështjeve dhe këndvështrimeve për botën t'u jepet vendi i duhur në sistemin arsimor, procesi rëndësishëm i edukimit të vlerave morale mund të marrë përmasa të reja përmes të mësuarit për fenë dhe sistemeve të tjera të vlerave.

Së katërti, nuk mjafton të mësuarit e historisë së feve ose e shfaqjeve të jashtme të feve. Feja nuk kufizohet në praktikën, objektet dhe ndërtesat. Është e nevojshme të përpiqemi të kuptojmë edhe gjuhën fetare siç përdoret nga besimtarët fetarë, duke përfshirë shprehjet e bindjeve të tyre, vlerat dhe emocionet. Të kuptuarit e tillë kërkon njohuri, por kërkon edhe qëndrime të caktuara dhe aftësi që rrisin vetëdijen dhe të kuptuarit e besimeve dhe vlerave të tjerëve, si dhe vlerave të cilat rikonfirmojnë dinjitetin njerëzor.

8 Parime themelore arsimore

Disa nga parimet mbi të cilat do të zbatohet përfshirja e dimensionit të edukimit fetar në arsim

Në kuadrin kushtetues, shkollat publike kanë detyrimin për të nxitur dhe për të zhvilluar vlerat themelore të shoqërisë demokratike, përmes kurrikulës dhe veprimtarive ekstrakurrikulare

Politika përfshirjes së studimit të fesë, e faktit fetar dhe e këndvështrimeve fetare, **krahas dhe në plotësim**, të studimit të këndvështrimeve të tjera jo fetare (filozofike, etike, politike etj.) do të jetë në përputhje me këto vlera dhe praktika shkollore duhet të përputhet me përparësitë kombëtare:

- **Barazia:** Procesi i arsimimit në përgjithësi dhe politika në fjalë do të synojnë të zhvillojnë kulturën demokratike në të cilën respektohen vlerat e ndryshme kulturore, fetare dhe traditat gjuhësore të të gjithëve.
- **Toleranca:** Feja në arsim duhet të kontribuojë në rritjen e tolerancës ndërmjet feve dhe në respektin ndërmjet anëtarëve ose ndjekësve të pikëpamjeve të ndryshme botërore **fetare ose shekullariste** në një shoqëri të përbashkët.

- **Diversiteti:** Për të rritur respektin e vetëdijshëm për diversitetin, institucionet arsimore duhet të kenë përgjegjësinë të rritjen e dijes për fetë e ndryshme, mirëkuptimin dhe respektin për fetë që veprojnë në Afrikën e Jugut dhe në botë.
- **Mendja e hapur:** Shkollat dhe e gjithë shoqëria luajnë rol në formimin dhe transmetimin e kulturës dhe institucionet arsimore duhet të nxisin dhe të zhvillojnë mendjen e hapur në të cilën nuk duhet të ekzistojnë përpjekjet e hapura ose të fshehta për të indoktrinuar nxënësit me një besim ose fe të veçantë.

9 Kompetencat themelore për nxënësit:

Kompetenca ndërkulturore e nxënësve dhe të kuptuarit e feve

Ky program synon:

- zhvillimin e qëndrimit tolerant dhe respektin për të drejtën për të mbajtur një besim të veçantë dhe qëndrime bazuar në njohjen e dinjitetit të lindur dhe liritë themelore të çdo qenieje njerëzore;
- edukimin e ndjeshmërisë për shumëllojshmërinë e bindjeve fetare dhe jofetare, si një element që kontribuon në pasurinë e Evropës;
- sigurimin që mësimdhënia e shumëllojshmërisë së bindjeve fetare dhe jofetare është në përputhje me qëllimet e edukimit për qytetari demokratike, të drejtat e njeriut dhe të respektimit të dinjitetit të barabartë të të gjithë individëve;
- promovimin e komunikimit dhe dialogut mes njerëzve nga prejardhje të ndryshme kulturore, fetare dhe jofetare;
- promovimin e qëndrimeve qytetare dhe sjelljeve të moderuara në shprehjen e identitetit të dikujt;
- sigurimin e mundësive për krijimin e hapësirave për dialog ndërkulturor me qëllim parandalimin e ndarjeve fetare ose kulturore;
- promovimin e njohurive për aspekte të ndryshme (simbolet, praktikat, etj) të diversitetit fetar;
- trajtimin e çështjeve të ndjeshme ose kundërthënëse të cilat mund të lindin nga shumëllojshmëria e bindjeve fetare dhe jofetare;

- zhvillimin e aftësive të vlerësimit kritik dhe reflektimit në lidhje me të kuptuarit e këndvështrimeve dhe mënyrave të jetës sipas feve të ndryshme dhe bindjeve jofetare;
- luftën kundër paragjyqimeve dhe stereotipave të cilët janë pengesa për dialogun ndërkulturor, edukimin dhe respektimin e dinjitetit të barabartë të të gjithë individëve;
- zhvillimin e aftësisë për të analizuar dhe për të interpretuar në mënyrë të paanshme larminë e informacionit në lidhje me shumëllojshmërinë e feve dhe bindjeve jofetare, pa cenuar nevojën për të respektuar bindjet fetare ose jofetare të nxënësve dhe pa cenuar edukimin fetar të caktuar jashtë sferës së edukimit publik.

10 Metoda

Në përgjithësi, metoda e trajtimit të çështjeve fetare dhe jo fetare në shkollë është ajo e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut, të cilat, në thelb, nxisin pjesëmarrjen e të nxënësve në procesin e të mësuarit, të krijimit dhe të rikrijimit të dijes, të njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve të cilat mudësojnë zhvillimin e kompetencës ndërkulturore në kuadrin e zhvillimit të kompetencës kyçe të qytetarisë, si dhe rritjen e kontributit të tyre edhe rishikimin e metodave të studimit.

Megjithatë në trajtimin e çështjeve në fjalë, po dallojmë metodat e mëposhtme:

1. Metoda **interpretuese**

Që nxit një kuptim fleksibël të feve dhe bindjeve jofetare dhe shmang vendosjen e tyre në një kornizë të ngurtë, të paracaktuar" (Këshilli i Evropës 2008a). Ajo mund të përdoret në klasa që janë fetare dhe jofetare të ndryshme, dhe edhe në situatat kur anëtarësimi në klasë nuk është i madh.

Si mund të përdoret metoda interpretuese për rritjen e kompetencës ndërkulturore?

Parimet kryesore të qasjes interpretuese mund të shprehen nga pikëpamja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nevojshme për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore, siç diskutohet në publikimin e Këshillit të Evropës Zhvillimi i Kompetencës Ndërkulturore përmes Edukimit. Për shembull:

Njohuritë dhe të kuptuarit e:

- koncepteve kyçe lidhur me një fe / traditë të veçantë fetare;
- këndvështrimeve, praktikave dhe besimeve të grupeve brenda një feje të caktuar;
- shembujve të teksteve kryesore dhe historive përkatëse etj;
- njohjes së shembujve që tregojnë diversitetin e besimit dhe praktikës brenda feve.

Aftësi të tilla si:

- dëgjimi i njerëzve të feve të tjera;
- bashkëveprimi me njerëz nga fetë e tjera;
- mbledhja e informacionit të besueshëm në lidhje me fetë e tjera;
- ndërmjetësimi i shkëmbimeve në lidhje me fetë.

Qëndrimet e tilla si:

- respekti i së drejtës së një personi për të ruajtur një këndvështrim të veçantë fetar apo jo-fetar;
- hapje ndaj njerëzve të feve dhe kulturave të ndryshme;
- hapje për të mësuar rreth feve të ndryshme;
- gatishmëri për të shmangur gjykimin;
- gatishmëri në tolerimin e paqartësive;
- vlerësimi i diversitetit fetar dhe kulturor.

Interpretimi kërkon:

Njohuritë dhe të kuptuarit e:

- koncepteve kyçe lidhur me një fe të caktuar;
- perspektivave, praktikave dhe besimeve të grupeve brenda një feje të caktuar

Aftësi të tilla si:

- Ndjeshmëria
- Larmia e këndvështrimeve
- Aftësia për të bashkëvepruar dhe për të dëgjuar njerëzit nga fe të ndryshme
- Aftësi diskutimi

Qëndrime të tilla si:

- hapja ndaj njerëzve të feve / feve të tjera / degëve të tjera të fesë së dikujt;
- gatishmëria për të shmangur gjykimin dhe toleruar paqartësitë;
- vlerësimi i diversitetit fetar dhe kulturor;
- fleksibilitet në sjellje kulturore dhe komunikuese

Reflektimi kërkon:

Njohuritë dhe të kuptuarit e:

- koncepteve kyçe të lidhur me një fe / traditë të veçantë fetare;
- perspektivave, praktikave dhe besimeve të grupeve brenda një feje të caktuar;
- ndërgjegjësimi për pikëpamjet dhe supozimet e dikujt tjetër.

Aftësi të tilla si:

- dëgjimi i njerëzve të feve të tjera / grupeve fetare;
- bashkëveprimi me njerëz nga fetë / grupet fetare të tjera;
- ndjeshmëria;
- larmia e këndvështrimeve;
- vlerësimi i këndvështrimeve të ndryshme fetare, jofetare, duke përfshirë ato të dikujt tjetër;

- vetëdija për paragjykimet dhe gjykimet e dikujt tjetër;
- fleksibiliteti dhe përshtatshmëria në sjelljen kulturore dhe komunikuese

Qëndrimet e tilla si:

- hapja për reflektim mbi besimet dhe kërkesat e veta të dikujt;
- vullneti për të mësuar nga të tjerët;
- gatishmëria për të bërë një kritikë të distancuar dhe të balancuar të pozicioneve të ndryshme fetare dhe jofetare

2. Metoda bashkëbiseduese,

Kjo metoda i mundëson nxënësit që të "angazhohen në dialog me persona të tjerë që zotërojnë vlera dhe ide të tjera" (Këshilli i Evropës 2008a) dhe është veçanërisht e dobishme në klasa të ndryshme për nga pikëpamja fetare dhe kulturore, por mund të përshtatet në situata të ndryshme.

Si mund të përdoret metoda bashkëbiseduese në rritjen e kompetencës ndërkulturore?

Parimet kryesore të metodës bashkëbiseduese mund të shprehen nga pikëpamja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nevojshme për të zhvilluar kompetencën ndërkulturore, siç diskutohet në Botimin e Këshillit të Evropës *Zhvillimi i kompetencës ndërkulturore përmes edukimit*.

Për shembull, dialogu i suksesshëm varet nga zhvillimi i qëndrimeve të tilla si:

- respektimi i së drejtës së një personi për të ruajtur një këndvështrim të veçantë fetar apo jo-fetar;
- vlerësimi i diversitetit fetar dhe kulturor;
- hapje ndaj njerëzve të feve dhe kulturave të ndryshme;
- hapje për të mësuar rreth feve të ndryshme;

- gatishmëri për të shmangur gjykimin;
- gatishmëri në tolerimin e paqartësive.

Këto qëndrime duhet të pasqyrohen në politikat mbarë-shkollore dhe në etikën e ndërveprimit në klasë, si edhe në kontributet e nxënësve individualë.

Aftësitë e nevojshme përfshijnë:

- Aftësinë për të vlerësuar perspektivat e ndryshme fetare / jofetare, përfshirë vendin e vet;
- ndërgjegjësimin e paragjytimeve dhe gjykimeve të veta të dikujt;
- dëgjimin i njerëzve të feve /grupeve fetare të tjera;
- bashkëveprimin me njerëz nga fe/grupe fetare të tjera;
- ndjeshmërinë;
- larmia e këndvështrimeve;
- vlerësimin e perspektivave të ndryshme fetare/jofetare përfshirë edhe ato të veta të dikujt.

Kjo qasje kontribuon në njohuritë dhe përvojën e mëparshme të fëmijëve. Njohuritë zhvillohen më në thellësi duke iu referuar një sërë burimesh, duke përfshirë:

- ndarjen e njohurive dhe përvojën e të tjerëve në klasë (duke përfshirë përdorimin e terminologjisë fetare, dhe vlerësimin e diversitetit të njohurive dhe përvojës),

- informacion të mëtejshëm kontekstual nga mësuesit, si shembuj të koncepteve kyçe, shqyrtimin e teksteve kryesore, mësimet dhe historinë përkatëse, citime nga këndvështrime të ndryshme, dhe përdorimin kritik të burimeve vizuale dhe të tjera (shihni Kapitullin 6 më poshtë).

11 Lëndë më vete/e integruar?

Ideja aktuale

1. Në arsimin e detyruar mund të trajtohet e integruar në lëndën qytetarisë
2. Në arsimin e mesëm mund të trajtohet:
 - a. E integruar në lëndën e qytetarisë, klasa 10, në kapitullin e kushtetutës dhe të drejtave të njeriut
 - b. Si kapitull i lëndës së sociologjisë (aktualisht është pjesë e saj)
 - c. Si pikëpamje filozofike në lëndën e filozofisë

Pilotimi dhe diskutimet e gjera do të na ndihmojnë për të gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme, në mënyrë që produkti dhe procesi t'i shërbejnë sa më mirë qëllimeve tona.

12 Pilotimi: synimet

Kurrikula e përfshirjes së njohurive për fenë dhe për këndvështrimet fetare dhe jo fetare për botën do të ketë statusin e një drafti, që do të pilotohet nga pikëpamja e:

- metodologjisë
- përzgjedhjes së përmbajtjes së përshtatshme
- përzgjedhjes së rrugëve dhe hapësirave më të përshtatshme për zhvillimin e saj në përputhje me qëllimet e arsimit.
- identifikimit të nevojave të trajnimit të mësuesit të përshtatshëm etj.

13 Mësuesi

Roli i mësuesit është vendimtar. Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për besimet dhe vlerat e tyre në lidhje me rolin e tyre profesional, dhe të jenë në gjendje të përshtatin një pozicion të paanshëm procedural (Jackson 1982). Ata duhet të kenë aftësi ndërmjetësimi dhe moderimi; dhe njohuri në fushën e feve dhe besimeve; dhe ndërgjegjësim për prejardhjen e të rinjve; dhe marrëdhënie kompetente brenda klasave. Personaliteti dhe profesionalizmi i mësuesit është i rëndësishëm, siç është marrëdhënia personale ndërmjet mësuesit dhe nxënësve. Nëse mësuesit marrin një rol shumë udhëzues, nxënësit mund të mbështeten në argumentet e mësuesit apo mund të mos marrin pjesë në diskutim. E gjithë kjo kërkon kërkesa të veçanta në trajnimin fillestar dhe në shërbim të mësuesve, dhe në mësuesit individualë për të informuar veten. Karakteri i përgjithshëm i shkollës gjithashtu duhet të jetë në përputhje me të mësuarit dialogues. Duke vepruar si lehtësues, roli i mësuesit është shpesh ai i "kryetarit të paanshëm", duke u siguruar që të gjitha pikëpamjet të përfaqësohen, dhe ndonjëherë si "informator objektiv", duke shpjeguar një sërë pikëpamjesh pa shprehur mendimin e saj apo të tij. Në rolin e tyre si moderatorë, mësuesit duhet të sigurohen që dialogu të mos dominohet nga nxënësit më të sigurt dhe më elokuentë, në mënyrë që ata më pak të aftët ose më pak të gatshmit të shprehen dhe të japin mendimin e tyre në një kontekst grupi

Disa aftësi të kërkuara nga mësuesit (shembuj):

Mësuesi:

- Reflekton për çështje etike që lidhen me fenë, politikën, të drejtat e njeriut dhe mjedisin
- Njeh parimet dhe praktikrat e feve kryesore në vend, zakonet, vlerat dhe besimet e kulturave dhe nënkulturave në vend, kushtetutën dhe të drejtat e njeriut.
- Njeh debatet etike në fushën e fesë, të politikës, të ekonomisë, të të drejtave të njeriut dhe të mjedisit
- Njeh dhe kupton ndikimin e klasave, racës, gjinisë dhe të forcave të tjera që ndikojnë në formimin e identitetit të njeriut në procesin e të mësuarit.

- Vlerëson dhe tregon respekt për njerëzit me vlera, besime, praktika dhe kultura të ndryshme
- Është i aftë të përgjigjet ndaj problemeve aktuale shoqërore dhe arsimore, që lidhen në mënyrë të veçantë me dhunën, abuzimin me drogën, abuzimin me fëmijët dhe gratë, me SIDA/AIDS dhe me shkatërrimin e mjedisit.
- Tregon dhembshuri, përkushtim dhe sjellje etike profesionale si dhe të kuptuarit e arsimit si faktor i rëndësishëm për mbrojtjen e fëmijës dhe për zhvillimin e tij të plotë si person.

Tema të mundshme për t'u zhvilluar në klasën e gjashtë

Tematika: Kultura

Nxënësit kuptojnë si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku dhe përshtaten ndaj kulturës. Ata vlerësojnë rolin e kulturës në formimin e jetës dhe të shoqërisë, ku jetojnë, si dhe jetës dhe shoqërisë së të tjerëve dhe marrin vendime mbi bazën e njohurive për kulturën në faza të ndryshme të shkollimit të tyre në emër të respektimit të larmisë kulturore dhe të bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve dhe kulturave.

Objektivat	Tematika të librit të lëndës Qytetaria 6	Tematika të sugjeruara për përfshirjen e aspektit fetar në larminë kulturore
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon faktin që individë të ndryshëm në grupin, në klasën ku bën pjesë kanë pikëpamje dhe përjetime të ndryshme për ngjarje, njerëz ose përvojat të ndryshme; lidh pikëpamjet e tiparet e ndryshme që janë karakteristikë e disa grupeve me përkatësinë e tyre kulturore; përshkruan se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë informacionet dhe përvojat. tregon me shembuj ndikime të gjuhës, të letërsisë, të arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës. dallon dhe përshkruan shembuj të reagimit të ndryshëm të individëve ose grupeve të ndryshme ndaj dukurive të ndryshme etj., mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre. 	<ol style="list-style-type: none"> Dita e kulturës A njihen dhe sa respektohen veçoritë e komuniteteve fetare, etnike, kulturore dhe sociale në vendin tonë? Festat tradicionale Arti i gatimit Shumëllojshmëria kulturore. Respekti për të gjitha kulturat Rolet dhe stereotipat gjinorë Tradita e emrit Kultura dhe shëndeti Dallimet kulturore dhe konfliktet 	<ol style="list-style-type: none"> Përkatësia fetare si element i diversitetit kulturor Festat që festojmë në familjet tona <ol style="list-style-type: none"> Veshjet karakteristike që lidhen me përkatësinë fetare. Kuptimi i tyre. Gatimet e veçanta që lidhen me fetë e ndryshme. Diversiteti fetar dhe respekti për të. Feja dhe qëndrimi ndaj femrës në to. Tradita e emrit në kultura të ndryshme fetare. Disa praktika fetare që lidhen me shëndetin.

<ul style="list-style-type: none"> dallon raste konfliktesh që shkaktohen nga qëndrimet e ndryshme që njerëz nga kultura ose nënkultura të ndryshme mbajnë ndaj të njëjtës sjellje ose dukuri; shpjegon se njerëzit nga kultura të ndryshme, janë të ngjashëm në shumë aspekte të rëndësishme, si qenie njerëzore që gëzojnë të njëjtat të drejta pavarësisht nga dallimet për arsye kulture, gjinie, race etj. 	<p>9. Konfliktet dhe mënyra e zgjidhjes së tyre.</p> <p>10. Dita e tolerancës</p>	<p>8. Dallimet në që lidhen me kulturën e feve të ndryshme dhe konfliktet e mundshme. A kemi më shumë të përbashkëta?</p> <p>9. Parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve që e kanë bazë në diversitetin fetar</p> <p>10. Larmia pasuri – të festojmë së bashku.</p>
---	---	---

Qytetaria klasa 10

<p>Tema 1: Ligji</p> <p>Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktura institucionesh sociale si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët, që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë.</p> <p>Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkëjetesën paqësore në shoqëri.</p>		
<p>Ligji Orë të sugjeruara: 6 Rezultatet e pritshme të të nxënit</p>		
<p>Njohuritë</p>	<p>Shkathësitë dhe aftësitë</p>	<p>Çështje që lidhen me fenë Tema të sugjeruara</p>
<p>Ligji, kuptimi, qëllimet, natyra dhe funksionet e tij.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shpjegon qëllimin e ligjit; 	

<p>Rëndësia e ligjit në shoqëri. Veprimi i ligjit në kohë dhe hapësirë.</p> <p>Ligji dhe vlerat. Rëndësia e marrjes parasysh të vlerave morale, politike, sociale dhe ekonomike në hartimin, kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e ligjeve.</p> <p>Llojet e ligjeve. Larmia e marrëdhënieve shoqërore dhe juridike dhe kuptimi për ligjet si rregullatorë të marrëdhënieve juridike në fushat përkatëse.</p> <p>Zbatimi i ligjit. Rëndësia e zbatimit të ligjit në shoqëri. Pasojat e zbatimit/moszbatimit të ligjit për individin dhe shoqërinë. Faktorët që ndikojnë në cilësinë e zbatimit të ligjit .</p>	<ul style="list-style-type: none"> • diskuton për funksionet dhe natyrën e ligjit në shoqëri; • identifikon dhe vlerësojë pasojat e veprimit apo mosveprimit të ligjit në shoqëri; • argumenton me shembuj nga jeta e përditshme domosdoshmërinë e ligjit për shoqërinë; • identifikon dhe diskutojnë për vlerat që qëndrojnë në themel të ligjeve; • shpjegon domosdoshmërinë e llojeve të ndryshme të ligjit në shoqëri; • demonstroi aftësinë të vlerësojnë vlerat në qëndrimin ndaj ligjeve të caktuara; • identifikon raste të shkeljeve të ndryshme ligjore dhe të diskutojë për pasojat e tyre për veten, familjen dhe mjedisin ku jeton; • evidenton dhe analizon faktorët që ndikojnë në qëndrimin e tij ndaj zbatimit të ligjit. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji dhe vlerat, ku e ka burimin ligji. Qëndrimet e ndryshme për çështjen në fjalë. 2. Zbatimi i ligjit. A ka vlerë ligji për të gjithë. Cilat janë përgjegjësitë e organizatave fetare në këtë drejtim? A ka dhe a duhet të ketë kufizime? Në emër të kujt?
<p>Tema 2: Kushtetuta e Shqipërisë Nxënësi njihet me thelbin e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit, si burim i legjislacionit dhe kriter i vlerësimit të tij. Ai njihet me parimet themelore mbi të cilat ngrihet qeverisja demokratike, të cilat janë edhe standardet mbi bazë të cilave gjykohet dhe vlerësohet realiteti demokratik në Shqipëri.</p>		
<p>Kushtetuta Orë të sugjeruara: 5 Rezultatet e të nxënit</p>		
<p>Njohuri</p>	<p>Aftësi</p>	<p>Çështje që lidhen me fenë Tema të sugjeruara</p>

<p>Kushtetuta – ligji më i lartë i shtetit. Kushtetuta si burim i legjislacionit. Kushtetuta dhe forma e shtetit. Kushtetuta dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kushtetuta dhe struktura e organeve të shtetit dhe kompetencat e tyre. Kushtetuta dhe ndarja dhe balancimi i pushteteve. Disa nga parimet bazë që qendrojnë në themel të Kushtetutës së Shqipërisë. Kuptimi i parimit të barazisë. Raporti ndërmjet lirisë dhe barazisë. Barazia formale dhe barazia reale.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan rolin e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit; • përshkruan parimet kryesore të mishëruara në kushtetutës shqiptare; • argumenton rëndësinë e mbështetjes në parimet e kushtetutës për hartimin dhe zbatimin e ligjeve; • argumenton domosdoshmërinë dhe rëndësinë e përmirësimit të kushtetutës në përputhje me dinamizmin dhe veçoritë e jetës ekonomike, sociale e politike të shoqërisë. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe feja 2. Sekularizmi dhe laiciteti. Laiciteti dhe kuptimet e ndryshme të tij. Laiciteti i jep gjithsecilit të drejtën e një gjykimi personal dhe respektin e kësaj të drejte dhe te të tjerët.
<p>Tema 3: Të drejtat e njeriut Nxënësit i jepet mundësia të hyjë në botën e të drejtave të njeriut, si një ndër treguesit kryesorë të një shoqërie demokratike. Ata mësojnë të drejtat e njeriut, rëndësinë, kufizimet dhe ndërlidhjen ndërmjet tyre</p>		
<p>Të drejtat e njeriut Orë të sugjeruara: 10 Rezultatet e të nxënit</p>		
<p>Njohuri</p>	<p>Aftësi</p>	<p>Çështje që lidhen me fenë Tema të sugjeruara</p>
<p>Ç’janë të drejtat e njeriut? Kategoritë e ndryshme të të drejtave të njeriut të drejtat civile e politike. Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të drejtat e mjedisit dhe të zhvillimit.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • jep një përkufizim të të drejtave të njeriut; • dallon lidhjen e të drejtave të njeriut me nevojat bazë të njeriut; 	<ol style="list-style-type: none"> 3. Liria. Kuptimet e ndryshme të saj në kohë dhe në hapësirë. 4. A jemi të lirë? Liria në këndvështrimin e feve të ndryshme.

<p>Cilat janë të drejtat që duhet të përfshihen në kartën e të drejtave? Pakti Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale e kulturore dhe Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike. Konventa Evropiane e të drejtave të njeriut. Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut. Të drejtat në konflikt. Kufizimi i të drejtave . Ndërlidhja e të drejtave. Disa nga të drejtat themelore të njeriut të përfshira në Kushtetutën e Shqipërisë. E drejta për të jetuar dhe për ruajtjen e integritetit fizik dhe moral të individit. E drejta e shprehjes. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë. E drejta për t'u informuar. E drejta për t'u martuar dhe patur familje. E drejta për t'u arsimuar. E drejta për punë. E drejta për t'u organizuar. E drejta për të gëzuar një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët E drejta për një proces të rregullt gjyqësor</p>	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon lidhjen e të drejtave të njeriut me vlerat dhe interesat e tyre jetësore të sotme dhe të perspektivës; • interpreton konceptimet e ndryshme për të drejtat e njeriut dhe të shprehë qëndrimin e tij vetjak lidhur me to; • përshkruan tiparet kryesore të të drejtave të njeriut dhe të shpjegojë rëndësinë e secilit prej tyre; • përshkruan përmbajtjen e disa prej dokumenteve themelore të të drejtave të njeriut dhe të institucioneve kryesore evropiane të të drejtave të njeriut; • dallon kategoritë kryesore të të drejtave sipas legjislacionit ndërkombëtar; • përshkruan dhe argumenton rëndësinë e kufizimit ligjor të të drejtave të njeriut dhe sferën dhe kushtet e kufizimit të tyre; • përshkruan, me shembuj në jeta e përditshme, lidhjen e të drejtave të njeriut dhe rëndësinë e saj për realizimin e tyre tërësor; • identifikon dhe shpjegon raste të të drejtave në konflikt dhe të shprehen për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet të drejtave. 	<ol style="list-style-type: none"> 5. Liria e besimit dhe e mosbesimit. A janë të barasvlershme? 6. Liria e shprehjes së përkatësisë fetare. Të drejtat në konflikt. 7. Diskriminimi për arsye të përkatësisë fetare dhe jo fetare. 8. A mund të kufizohet liria fetare? Në ç'rrethana Konventa evropiane e të drejtave të njeriut. 9. E drejta për t'u informuar. A duhet të informohen fëmijët për fenë dhe këndvështrimet fetare? 10. E drejta për t'u martuar dhe pasur familje në kultura të ndryshme.
---	--	---

Tema 4: Arsimimi

Shkolla luan një rol të pazëvendësueshëm për rritjen dhe edukimin e fëmijës nga pikëpamja shoqërore dhe kulturore. Ajo i përgatit fëmijët, jo vetëm për të hyrë me këmbë të sigurt në botën e të rriturve, por edhe që t'i aftësuar të vetëzhvillohen e t'i përshtaten më mirë ndryshimeve të botës.

Arsimimi Orë të sugjeruara:6 Rezultatet e të nxënit		
Njohuritë	Aftësitë	Çështje që lidhen me fenë Tema të sugjeruara
<p>Shkolla, funksioni i saj. Rëndësia e arsimimit. Arsimimi si e drejtë themelore. Konventa për të drejtat e fëmijës. Kushtetuta e Shqipërisë për arsimin. Ligji për arsimin parauniversitar. Si realizohet e drejta për arsimim. Institucionet shkollore, roli dhe përgjegjësia e tyre për të garantuar të drejtën për arsim për të gjithë.</p> <p>Çfarë duhet të studjojmë në shkollë dhe përse? Cilësia dhe barazia në arsim. Si garantohen shanse të barabarta për të gjithë nxënësit? Si garantoheret cilësia e shërbimit arsimor për të gjithë?</p> <p>Kush duhet të vendosë për arsimimin tim? Reformat arsimore, arsyet e reformave dhe zbatimi i tyre. Pjesëmarrja e të rinjve në projektimin e reformave arsimore.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • argumenton rëndësinë e arsimimit për jetën e secilit; • argumenton të drejtën për arsim si e drejtë themelore; • argumenton rëndësinë e mbrojtjes me ligj të drejtës për arsimim; • përshkruan disa nga realizimet e ligjit shqiptar për arsimin para-universitar; • përshkruan ndryshimet e shkollës në vite; • përshkruan mundësitë që ofron arsimimi në vendin tonë; • dallon rolin e shkollës dhe të mësuesve; • tregon disa nga problemet me të cilat përballlet arsimi dhe shkolla jonë sot; • përdor njohuritë dhe mjetet e tjera që ofron shkolla për të bërë zgjedhje për vazhdimësinë e arsimimit të tij; • mbledh fakte e të dhëna për problemet e shkollës e të bëjë interpretimin e tyre; 	<p>11. E drejta për arsim dhe feja.</p> <p>12. E drejta për arsim dhe e drejta për shprehjen e përkatësisë fetare (simbolet fetare në shkollë) A ka e drejta për arsim përparësi ndaj të drejtës për të përdorur simbolet fetare në shkollat publike?</p> <p>13. E drejta e prindërve për të zgjedhur edukimin e fëmijëve të tyre. A ka të drejtë prindi të kërkojë që fëmija e tij të lejohet të mos ndjekë një orë mësimi për fenë?</p> <p>14. A ka të drejtë prindi të ndalojë fëmijën të marrë pjesë në programin shkollos sekularist që bie ndesh me bindjet e tij fetare?</p>

<p>Shkolla si një shoqëri multi etnike ose multi kulturore. Problemet e shkollës sot. A i shërben shkolla interesave të nxënësve? Çfarë duhet të sigurojë shkolla për të përmbushur këto interesa? Analafabetizmi, analafabetizmi funksional. Standardet e shkollës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> parashikon pasoja të ndryshme të funksionet e shkollës të qëndrimeve, politikave ose ligjeve të ndryshme. 	<p>15. Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut për të drejtën për të mos ndjekur mësimet për fenë.</p> <p>16. E drejta e fëmijës për informim në shkollë dhe ndalimi i edukimit fetar .</p>
<p>Tema 5: Shëndeti Shëndeti është një e drejtë themelore e njeriut. Ruajtja e tij nga rreziqet dhe “armiqtë e shumtë duhet të jetë përparësi jo vetëm e individëve që e kanë por edhe e shtetit. Njohja e tij si e drejtë dhe pranimi i detyrimeve për ruajtjen dhe mirëqënien e tij duhet të jetë detyrim i shtetit dhe i shoqërisë. Në këtë kuadër shkolla duhet të luajë rolin kryesor të informimit në lidhje me shëndetin, rreziqet, përkujdesjet etj.</p>		
<p>Shëndeti Orë të sugjeruara: 6 Rezultatet e pritshme të të nxënit</p>		
<p>Njohuri</p>	<p>Aftësi</p>	<p>Çështje që lidhen me fenë Tema të sugjeruara</p>
<p>Shëndeti si një e drejtë themelore. Shëndeti në dokumentet e të drejtave të njeriut. Dhe në legjislacionin shqiptar. Mbrojtja e shëndetit në vendin tonë. Parandalimi dhe informacioni. Masat dhe veprimtaritë vetjake në mbrojtje të shëndetit.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> jep një përkufizim për shëndetin; vlerëson shëndetin si një të drejtë njerëzore dhe të tregojë mbrojtjen e tij në dokumentet e të drejtave të njeriut; argumenton domosdoshmërinë e mbrojtjes me ligj të shëndetit; 	<p>17. Praktikrat fetare dhe shëndeti</p> <p>18. E drejta e jetës. Embrioni</p> <p>19. Aborti në kultura të ndryshme fetare dhe jo fetare.</p>

<p>Rreziqet e shëndetit dhe siguria. Disa nga mjediset jetësore dhe rreziqet që shoqërojnë veprimtarinë tonë të përditshme.</p> <p>Cilët janë disa nga armiqtë kryesorë të shëndetit ? Legjislacioni shqiptar në mbrojtje të shëndetit kundër armiqve të tillë (sida, alkoholi, droga, duhani, dopingu etj. Disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin dhe qëndrimet etike për to. Mbështetja me legjislacionin përkatës Detyrimet individuale dhe shoqërore për shëndetin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • tregon si legjislacioni shqiptar e mbron shëndetin; • argumenton rëndësinë e mbrojtjes paraprake të shëndetit dhe e parandalimit të veprimit të faktorëve që e dëmtojnë atë; • argumenton rëndësinë e informimit publik për çështjet e shëndetit; • identifikon dhe të përshkruajë disa nga problemet e sotme në lidhje me shëndetin dhe llojet e tyre; • diskuton për shkaqet kryesore të disa prej problemeve kryesore që lidhen me shëndetin; • dallon disa nga shtresat e pafavorizuara të shoqërisë dhe problemet e tyre që lidhen me shëndetin; • tregon si ligji shqiptar mbron shëndetin e të gjitha shtresave të shoqërisë; • rendit disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin dhe shpreh qëndrimin e tij për to; • përcakton dhe diskuton për detyrimet individuale dhe shoqërore për mbrojtjen e shëndetit. 	
<p>Tema 6: Mjedisi Mjedisi përbën burimin themelor për jetën në tokë. Megjithatë ai është rrezikuar dhe rrezikohet vazhdimisht nga veprimtaria njerëzore. Brezat e ardhshëm do të trashëgojnë gjithnjë e më pak nga mjedisi i sotëm, pasi i shfrytëzohet pa kriter nga brezat e sotëm. Edukimi i të rinjve me përgjegjësinë e ruajtjes dhe zhvillimit të tij është një përparësi.</p>		
<p>Mjedisi Orë të sugjeruara: 6</p>		

Rezultatet e pritshme të të nxënit		
Njohuri	Aftësi	Çështje që lidhen me fenë Tema të sugjeruara
<p>Ekologjia. Rreziqet për planetin. Mjedisi i shëndetshëm si një e drejtë njerëzore Përpyqjet e njerëzimit për të ruajtur planetin. Roli i shkencës dhe i teknologjisë për ruajtjen e planetit. Si mund të ruajmë planetin? Energjia. Kontradiktat e zhvillimit. Zhvillimi i qëndrueshëm. Politikat evropiane për ruajtjen e mjedisit. Legjislacioni shqiptar për ruajtjen e mjedisit . Ruajtja dhe zhvillimi i mjedisit është përgjegjësi për të gjithë. Si të jetojmë në një mjedis të shëndetshëm dhe për një mjedis të shëndetshëm.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjego lidhjen ndërmjet ruajtjes së mjedisit dhe ruajtjes së vetë njeriut; • vlerëson mjedisin e shëndetshëm si një të drejtë të njeriut ; • tregon si legjislacioni shqiptar mbrohet mjedisin; • dallon rreziqet me të cilat përballet sot planeti ynë; • identifikon disa nga format e ndotjes së mjedisit në Shqipëri; • rendit disa nga llojet kryesore të ndotjes së mjedisit në bashkësinë ku jeton; • bën kërkime të pavarura ose në grup për mënyrën se si trajtohet mjedisi në nivele të ndryshme të qeverisjes vendore ose qendrore; • përkufizon me fjalët e tij termin zhvillim i qëndrueshëm; • shpjegon rëndësinë e marrjes parasysh të pasojave të veprimeve dhe sjelljeve tona mjedisore për brezat e ardhshëm dhe për ardhmërinë në përgjithësi; • tregon me shembuj që mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi individuale; 	<p>20. Ndotja dhe katastrofat natyrore. A mund të parandalohen? Cilat janë disa nga qëndrimet në lidhje me pushtetin e njeriut për të qenë zot i vetes.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> parashikon disa nga pasojat që kanë për brezat e ardhshëm, zgjedhjet që bëjnë individët, grupet ose shteti. 	
Tema 7: Konsumatori		
Konsumatori Orë të sugjeruara: 8 Rezultatet e pritshme të nxënësve		
Njohuri	Aftësi	Çështje që lidhen me fenë Tema të sugjeruara
<p>E drejta e konsumatorit dhe përmbajtja e saj.</p> <p>Çdo të thotë të jesh konsumator kur blen, pas blerjes?</p> <p>Faktorët që ndikojnë në sjelljen e konsumatorit</p> <p>Zgjedhja e konsumatorit, faktorët që e përcaktojnë atë.</p> <p>Kontrata. Kuptimi i kontratës në ligjin mbi konsumatorin, elementët dhe kushtet e lidhjes së saj. Llojet kryesore të kontratave, pasojat e kontratës, prishja e kontratës dhe pasojat e prishjes së saj.</p> <p>Garancia si pjesë e kontratës, përmbajtja e saj. Si lexohet një garanci.</p> <p>Reklama dhe konsumatori.</p> <p>Procedurat e mbrojtjes pas blerjes.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> përshkruan tiparet kryesore të ligjit mbi konsumatorin; të përcakton përmbajtjen e konceptit konsumator dhe të përshkruajë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit; përshkruan disa nga faktorët që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit; demostron aftësi të shmangë dhe të zgjidhë probleme të thjeshta si konsumator; analizon dhe përshkruan elementët kryesorë të kontratës së shitblerjes; shpjegon elementët dhe rëndësinë e garancisë për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të konsumatorit; përshkruan funksionet e reklamës dhe të analizojë raste të keqpërdorimit të saj si 	<p>21. Sjellja konsumatore në kultura të ndryshme fetare.</p>

	<p>shkelje e të interesave dhe të drjtave të konsumatorit;</p> <ul style="list-style-type: none"> identifikon organizata që punojnë e luftojnë për zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit. 	
<p>Tema 8: Puna dhe e drejta e punës E drejta e punës sanksionohet në Kushtetutë dhe mbrohet nga legjislacioni i veçanta i cili përmbledhet dhe kodifikohet në Kodin e punës. Puna është mjedisi dhe mjeti për realizimin e individit, por që shpesh herë është edhe mjedisi i abuzimit me të. Njohja e legjislacionit të punës është i rëndësishëm për mbrojtjen e individve si punëmarrës.</p>		
<p>Puna dhe e drejta e punës Orë të sugjeruara: 6 Rezultatet e pritshme të të nxënit</p>		
Njohuri	Aftësi	
<p>Kushtetuta për të drejtën e punës.</p> <p>Kodi i Punës dhe mbrojtja e interesave të punonjësit.</p> <p>Roli i legjislacionit të punës në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve.</p> <p>Të drejtat e punonjësve. Mënyrat e mbrojtjes së tyre.</p> <p>Kontrata e punës.</p> <p>Kuptimi i kontratës së punës. Kushtet e lidhjes së kontratës së punës. Marrëveshja ndërmjet palëve.</p> <p>Shkaku i kontratës, objekti i saj. Forma e kontratës.</p> <p>Llojet e kontratave të punës.</p> <p>Kushtet e punës. Kuptimi i kushteve të punës</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> jep një përcaktim të termave punë dhe punoj; rendit lloje të ndryshme punësh; dallon faktorët kryesorë që mundësojnë një proces prodhues; tregon përgjegjësinë e shtetit për punën; rendit të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve sipas legjislacionit shqiptar për punën; rendit disa nga hapat e domosdoshëm për të kërkuar punë; përshkruan tablonë e disa prej ndryshimeve kryesore që ka pësuar bota e punës në shoqërinë shqiptare dhe pasojat e tyre për botën e punës në Shqipëri; 	

<p>Mbrojtja në punë. Detyrimet e punëmarrësit për të siguruar mbrojtjen në punë. Mbrojtja e veçantë e të miturve në punë. Koha e punës. Koha e lejes dhe pushimit.</p> <p>Zgjidhja e kontratës dhe humbja e punës. Kuptimi i zgjidhjes së kontratës. Rastet e zgjidhjes së kontratës. Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme.</p> <p>Zgjidhja e kontratës për shkaqe të arsyeshme. Afati i zgjidhjes së kontratës.</p> <p>Sigurimi shoqëror. Kuptimi mbi sigurimin shoqëror. Sigurimi shoqëror në legjislacionin shqiptar. Sigurimi shoqëror dhe interesat aktuale dhe perspektive të punonjësve. Sigurimi shoqëror dhe realiteti shqiptar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan disa nga tiparet kryesore të botës së punës në Evropë dhe kërkesat që shtron ajo për të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të jetojnë në të; • diskuton për disa nga dukuritë, me të cilat ndeshen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë; • mbledh fakte e të dhëna për problemet e punës së fëmijëve e të bëjë interpretimin e tyre; • parashikon pasoja në aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës qëndrime ose praktika të caktuara që lidhen me punën e fëmijëve në familje ose në shoqëri; • përshkruan disa nga të drejtat e tij në punë dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre; • diskuton për rëndësinë e legjislacionit të punës për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të punonjësve; • jep përkufizimin e kontratës sipas legjislacionit dhe të përshkruajë elementët e saj; • rendit disa nga hapat e domosdoshëm për mbrojtjen e interesave të tij në punë. 	
<p>Tema 9: Siguria në rrugë</p>		
<p style="text-align: center;">Siguria në rrugë Orë të sugjeruara: 8 Rezultatet e pritshme të nxënimit</p>		
<p style="text-align: center;">Njohuri</p>	<p style="text-align: center;">Aftësi</p>	

<p>Kodi rrugor. Sinjalet rrugore dhe kuptimi i tyre. Llojet e sinjaleve rrugore. Këmbësorët . Qarkullimi i këmbësorëve. Kalimi i rrugës. Kalimi i këmbësorëve në kryqëzime. Përdorimi i mjeteve publike.</p> <p>Qarkullimi i çiklistëve. Qarkullimi i biçikletave. Qendrimi në karrexhatë. Kthesat dhe ndryshimi i drejtimit. Kryqëzimet dhe rregullat e përparësisë. Shpejtësia dhe distanca e sigurisë. Parakalimet. Qarkullimi i motoçikletave .</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan qëllimin e kodit rrugor dhe funksionet kryesore të tij; • përcakton sinjalet kryesore rrugore që rregullojnë qarkullimin e këmbësorëve, biçikletave dhe motoçikletave; • përcakton sjelljen e këmbësorëve, biçikletave dhe motoçikletave në rrugë në raport me përdoruesit e tjerë të rrugës; • merr vendim për lëvizjen e tij në rrugë në përputhje me rregullat e qarkullimit rrugor; • gjykon për rregullsinë ose parregullsinë e lëvizjes së përdoruesve të rrugës; • vlerëson dhe të parashikojë pasojat e moszbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor për individët dhe shoqërinë etj. 	
<p>Tema 10: E drejta për informim dhe ligji për medien</p>		
<p>Informacioni është thelbësor për çdo shoqëri demokratike. Ai është e drejtë dhe detyrim. Ai është pushtet dhe për këtë arsye, shpesh herë përdoret në mënyrë të padrejtë, në dëm të interesave të individëve, grupeve ose shoqërisë. Si i tillë ai duhet të jetë vazhdimisht në qendër të shikimit kritik.</p>		
<p align="center">E drejta për informim dhe ligji për medien Orë të sugjeruara: 6 Rezultatet e pritshme të të nxënit</p>		
<p align="center">Njohuri</p>	<p align="center">Aftësi</p>	<p align="center">Çështje që lidhen me fenë Tema të sugjeruara</p>
<p>Informimi dhe rëndësia e tij Informimi dhe mjetet e tij.</p>	<p>Nxënësi:</p>	

<p>Mjetet tradicionale të informimit. Mjetet e reja te informimit. Të përditshmet. Gjuha e informimit dhe e pamjeve . Media dhe mitet e saj (mitet e TV) TV dhe ligji për të miturit. Interneti, avantazhet dhe disavantazhet. Rreziqet. Informacioni në dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut. E drejta e informimit në Kushtetutën e Shqipërisë . Legjislacioni shqiptar për medien e shkruar dhe atë elektronike. E drejta e informimit dhe abuzimet me të. Disa nga problemet bashkëkohore në lidhje me informimin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • jep një përshkrim të konceptit informacion; • përshkruan mjetet kryesore tradicionale dhe të reja të informacionit; • flet për mundësitë dhe kufizimet e informacionit; • shpjegon rëndësinë e vlerësimit kritik të informacionit; • shpreh qëndrimin e tij për lirinë e medias dhe për ligjin shqiptar që lidhet me të drejtën e informacionit; • mbledh fakte e të dhëna për problemet e informimit të të rinjve e të bëjë interpretimin e tyre; • parashikon pasoja të ndryshme të qëndrimeve të medias në jetën e fëmijës. 	<p>22. E drejta për informim. Rreziqet e tij. Vlerësimi kritik i informacionit.</p>
---	--	---